



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 17.12.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i 2 Akteve Normative me fuqinë e ligjit. Konkretisht:

1. Akti Normativ "Per perballimin e pasojave te fatkeqesise natyrore"
2. Akti Normativ "Per perdorimin e procesudres se persheptuar per subvencionimin e pageses se qirase se baneses per familjet e mbetura te pastreha, si pasoje e fatkeqesise natyrore, termetit te dates 26.11.2019"

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Reme Lala,
Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, , Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi,
Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita, Ylli
Shehu.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Suzana Topi,

Te ftuar

Ministria e Financave dhe Ekonomise

1. Zv/Ministrja Znj. Belinda Ikonomi,
2. Znj. Mimoza Dhembli Drejtoreshe e Pergjithshme e Buxhetit,
3. Z. Nikolla Lera Drejtor I Pergjithshem I Politikave makroekonomike,
4. Z. Saimir Mucmataj Drejtor,

5. Znj. Boriانا Hasanllari Specialiste tek Drejtoria e Strehimit,
6. Znj. Visiana Shamo Specialiste tek Drejtoria e Strehimit.

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – ... draftligj specifik për të kaluar, i cili ka ardhur si akt normativ nga qeveria.

Për dijeni të medias, por edhe të komisionit, akti normativ ka hyrë në fuqi dje pas miratimit në qeveri. Si parlament ne kemi vendosur ta kalojmë sot dhe për shkak se është një ligj i rëndësishëm do ta prezantojmë nesër në seancë.

Relatore e ligjit “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” është zonja Blerina Gjylameti. Për publikun, komisionin apo edhe për median, ligji krijon urën midis gjendjes së emergjencës dhe përballimit të të gjitha pasojave që lënë fatkeqësitë natyrore; tërmetet, përmbytjet apo ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore që nuk po e përmendim dhe do Zoti nuk kemi.

Gjithsesi, përgatitja në aspektin ligjor dhe procedural është e rëndësishme. Ligji, përveç se jep definicione të sakta të procedurave dhe të programeve, shkon në detajet e financimit, e përgjegjësi të pushtetit vendor, pushtetit qendror dhe në detaje të trajtimit deri në çështje specifike ose nënprograme brenda programeve të ndryshme.

Në të njëjtën kohë dua të them që Shqipëria nuk ka pasur më parë një ligj si ky, por është mjaftuar me ligjin e emergjencave. Emergjencat janë të kufizuara në kohë, janë 30-ditore, me VKM, por kur kalojnë 30 ditë, qeveria duhet të vijë në parlament për zgjatjen e gjendjes. Gjendja e jashtëzakonshme nuk zgjat më shumë se 3 apo 6 muaj në raste specifike, kurse rindërtimi mund të zgjasë 1 apo 2 vjet, sepse pasojat mund të jenë të mëdha. Për herë të parë ky ligj jep instrumente në dorë të qeverisë. Detyron qeverinë të ketë një plan rindërtimi dhe detyron donatorët të jenë brenda një plani, por jo brenda një buxheti.

Ligji direkt dhe indirekt jep fuqi kordinative, sepse kanë filluar të spekulojnë edhe qejflinjte e spekulimeve. Praktikisht programi i rindërtimit do të jetë i përcaktuar buxhetor me njësi ekzekutuese ato tradicionale. Në rastin konkret njësitë ekzekutuese nuk do të jenë as ministri i Shtetit dhe as Kryeministri, por do të jenë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, njësitë vendore, të cilat vendosen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pra, për të gjithë ata që kanë qejf të abuzojnë me *fake news*, as Kryeministri dhe as ministri i Shtetit për Rindërtimin nuk janë njësi zbatuese. Njësitë zbatuese do të jenë njësitë

tradicionale të zbatimit të projekteve të investimeve publike: Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, ndoshta në raste konkrete të infrastrukturës shoqëruese që përfshihet edhe këtu mund të jetë Ministria e Infrastrukturës nëpërmjet institucioneve të veta, si dhe njësitë vendore. Të jemi të qartë që të mbyllet diskutimi që fillon nga imagjinatat e medias deri te përsiatjet boshe të pseudospecialistëve dhe pseudoanalistëve.

Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Blerina.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Nëpërmjet këtij akti normativ synohet të përcaktohet kuadri i nevojshëm ligjor, që do të mundësojë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera, që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat për shkak të intensitetit dhe të shtrirjes së tyre kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve qendrore dhe vendore, që kanë kompetenca në marrjen e masave për përballimin e këtyre situatave. Situata me të cilën u përball vendi ynë si rezultat i tërmetit të datës 26 nëntor 2019 bën të nevojshëm propozimin e një kuadri rregullator, i cili duhet të normojë krijimin dhe funksionimin e organeve përgjegjëse, të cilat duhet të angazhohen për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, programet e rindërtimit, krijimin e fondit të posaçëm të rindërtimit dhe procedurat përkatëse të përdorimit të tij.

Në këtë aspekt, vendi ynë duhet të ketë një kuadër rregullator, i cili, përveç parandalimit, koordinimit dhe përgatitjes në rast të fatkeqësive natyrore, duhet të rregullojë edhe menaxhimin në mënyrë efektive të pasojave afatmesme dhe afatgjata të gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësive të tjera, duke parashikuar detyrat e autoriteteve përgjegjëse në këtë aspekt, programet dhe procedurat përkatëse të rindërtimit me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të sigurisë kombëtare.

Rimëkëmbja pas gjendjes së fatkeqësisë natyrore ka qëllim garantimin e kthimit të çdo subjekti të prekur nga fatkeqësia natyrore në gjendjen fillestare, nxitjen e praktikave që ulin mundësinë për shkaktimin e pasojave në të ardhmen nga fatkeqësitë natyrore, si dhe forcimin e aftësive të komuniteteve të prekura për t'i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në të ardhmen. Autoritetet publike përgjatë procesit të rindërtimit janë të detyruara të garantojnë përdorimin e kushteve dhe të teknikave që parandalojnë rreziqet e reja të fatkeqësive natyrore në të ardhmen në përputhje me objektivat sociale të shtetit të sanksionuara në nenin 59 të Kushtetutës, parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, strehimit të përshtatshëm, barazisë dhe mosdiskriminimit, informimit dhe transparencës, si dhe parimin e kontrollit dhe

përgjegjshmërinë e burimeve financiare. Në thelb ky akt normativ përshkruhet nga koncepti “Rindërto më mirë”. Për sa më sipër, e ftoj komisionin ta miratojmë atë.

Ndërkohë, akti i dytë normativ që do të diskutojmë sot është “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore të tërmetit të datës 26.11.2019”

Në kuadër të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës Tiranë dhe Lezhë, me vendimin nr. 750, datë 27. 11. 2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, i ndryshuar, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26. 11. 2019, familjeve të viktimave do t’u ofrohet subvencionimi i qirasë për një vit, sipas procedurave të përshpejtuara. Akti normativ propozohet për shkak të nevojës që lind për të kapërcyer disa procedura, afate kohore dhe dokumente standarde që kërkohen nga ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Miratimi i këtij akti normativ është diktuar në kuadër të masave që po merr qeveria për t’u ardhur në ndihmë familjarëve, banesat e të cilave, si rezultat i tërmetit të datës 26. 11. 2019, janë shembur ose janë deklaruar të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit. Subvencionimi i qirasë është një instrument financiar që i jep zgjidhje të shpejtë situatës së strehimit të familjeve që kanë ngelur të pastreha si rezultat i fatkeqësisë natyrore.

Sipas informacionit të datës 4. 12. 2019 nga Dispeçeri (burimi i informacionit nga media) rezultojnë:

shtëpi të shembura: qarku Durrës 1183 shtëpi, Tiranë 131 shtëpi, Dibër 2 shtëpi;

shtëpi të dëmtuara rëndë janë 5514: në Durrës, një nga qarqet që është prekur më shumë, 3838, në Tiranë 1311, në Lezhë 168, në Kukës 150, në Dibër 13, në Elbasan 34;

pallate të dëmtuara rëndë janë 558: në Durrës 35, në Tiranë 461, në Lezhë 56, në Kukës 4, në Dibër 1, në Elbasan 1;

pallate të pabanueshëm: në Tiranë 20.

Lista e plotë pritet të përditësohet, por sipas të dhënave të mësipërme rezultojnë rreth 6697 familje në banesa, ndërkohë që numri i familjeve që banojnë në pallatet e dëmtuara rënde dhe ato që janë shembur nuk është i raportuar ende.

Subvencionimi i qirasë është një instrument financiar i parashikuar në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”. Procedurat e dhënies së subvencionimit të qirasë në favor të familjeve përfituese nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, afatet kohore dhe dokumentacioni që ato duhet të dorëzojnë në njësitë e qeverisjes vendore, si edhe procedurat që njësitë e vetëqeverisjes vendore aplikojnë për të përfituar mbështetje nga buxheti i shtetit, kur ato nuk disponojnë të

ardhura të mjaftueshme, janë përcaktuar pjesërisht në ligj dhe më pas detajuar me akte nënligjore, të cilat janë miratuar këtë vit.

Ky akt normativ synon të shkurtojë procedurat, afatet kohore dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë familjet përfituese, si edhe bashkitë për të përfituar mbështetje buxhetore në rastin kur kanë të ardhura të pamjaftueshme, duke shmangur disa parashikime të ligjit nr. 22/2018 (nenet 35, 37, 39).

Vlen për t'u përmendur se efekti në buxhetin e shtetit për bonusin e qirasë për 6 mijë familje është rreth 1 miliard lekë.

Për sa më sipër dhe duke vlerësuar maksimalisht përgjigjen që duhet të kemi ndaj të gjitha familjeve, të cilat janë prekur nga tërmeti, unë i propozoj komisionit ta miratojmë sa më shpejt atë në mënyrë të tillë që të kalojë në seancën e nesërme.

Faleminderit!

Nëse ka ndonjë pyetje ose koment, mund ta shprehni.

Korab Lita – Dihet nga të gjithë që jemi përballë një fatkeqësie natyrore dhe na takon neve si drejtues dhe si parlamentarë që të jemi shumë të ndjeshëm ndaj qytetarëve tanë. Në këtë situatë unë mendoj se, por besoj se kam edhe mbështetjen e deputetëve të opozitës, duke qenë të ndërgjegjshëm se këto dy akte normative u shërbejnë qytetarëve dhe ndikojnë në zbutjen e probleme që ju ka shkaktuar fatkeqësia natyrore, ne do t'i votojmë të dy projekt-aktet.

Faleminderit!

Edlira Hyseni – Unë dua të bëj një koment të shkurtër. Padyshim që të dy aktet do të marrin mbështetjen tonë, sepse janë akte të përpiluara në kushtet e situatës në të cilën jemi. Me sa po shikoj, sepse tani po njihemi me aktet, përmbajtja ka të bëjë më shumë me formalizimin e procedurave që tashmë po zbatohen, sepse po lexoj dokumentet që duhet të kërkojnë ata që aplikojnë për bonusin e qirasë, procedurë e cila po ndiqet realisht, të paktën në bashkinë e Durrësit në dijeninë time. Me këtë akt normativ me fuqinë e ligjit formalizohet e gjithë procedura që po ndiqet realisht në këtë moment nga familjet që aplikojnë për bonusin e qirasë. Akti normativ me fuqinë e ligjit i referohet situatës aktuale për këtë fatkeqësi natyrore, për kushtet e tërmetit në të cilat Shqipëria ndodhet.

Meqenëse jemi të gjithë në ndjekje të kësaj situatë dhe të zgjidhjes sa më të shpejtë, siç tha kryetari, procesi i rindërtimit padyshim që do të kërkoj kohë, por jemi në kushtet e masave të para emergjente, tani qytetarët vetëm pyesin dhe unë po përpiqem të bëj pyetjen e thjeshtë që bëjnë të gjithë.

E para, a keni një ide të qartë dhe të sigurt që do të mbulohen të gjitha familjet, banesat e të cilëve janë shpallur të pabanueshme dhe nuk mund të hyjnë në shtëpitë e tyre? Pra, do të

përfitojnë nga bonusi i qirasë? Të paktën të qetësojmë qytetarët që sot janë në kushtet e banesës në hotele apo kudo jashtë shtëpie.

E dyta, në Durrës është bërë e vështirë gjetja e apartamenteve me qira. Mbase Tirana është ndryshe, por Durrësi ka pasur gjithmonë treg të limituar. Kështu që shumë familje, edhe pse i plotësojnë kushtet për të marrë bonusin e qirasë, kanë vështirësi për të gjetur një apartament me qira, sepse është kusht paraqitja e kontratës së qirasë. Si mendoni se mund të zgjidhet situata për familjarët që nuk po gjejnë dot një shtëpi me qira në bashkinë ku ata ndodhen dhe duan të qëndrojnë, sepse e kanë të lidhur punën dhe interesat? Pra, si do të funksionojmë në këto raste?

E fundit, përveç rasteve kur familjet do të marrin bonusin e qirasë për të jetuar të paktën për një vit, po për shtëpitë që kanë nevojë për shpenzimet e riparime çfarë do të bëhet, sepse janë shumë familje që presin? A ka një parashikim? E di që emergjente është të hyjnë në një shtëpi familjet që janë pa shtëpi, por a kemi një fond apo parashikim për familjet që u janë dëmtuar banesat dhe presin riparimet, si dhe kur do të kryhet?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, Belinda.

Belinda Ikonomi – Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes nëse do të përfitojnë të gjithë qytetarët nga subvencionimi i qirasë

...

Arben Ahmetaj – Më fal! Ju kërkoj ndjesë!

Moza, mund të vazhdosh që të mbyllim atë që thamë. Që të mos harxhosh kohën kot.

Belinda Ikonomi – Në buxhetin e vitit 2020 është parashikuar një fond prej 1,2 miliardë lekësh për subvencionimin e qirasë. Nga krahu tjetër është thënë që këto janë subvencionime nga buxheti i shtetit, por ndërkohë ky është një proces i përbashkët me njësitë e qeverisjes vendore. Padyshim, çfarëdolloj kërkesë që do të vijë nga njësitë e qeverisjes vendore i pastrehu do të akomodohet me fondet e buxhetit të shtetit, nëse nuk kanë mundësi njësitë e qeverisjes vendore për të përmbushur dhe për të dhënë këtë lloj subvencionimi për qytetarët.

Për sa i përket pyetjes së dytë lidhur me specifikën e qytetit të Durrësit, ndryshimet ligjore në aktin normativ lejojnë që në radhë të parë të mos kemi kontratat e qirasë. Ky është lehtësimi i parë që po bëhet në procedurat normale të standardizuara të ligji “Për strehimin social”. E dyta, në nenin 4 parashikohet rasti që edhe kur banesa e dëmtuar ndodhet në një qytet tjetër.... Pra, e lë të hapur mundësinë që qytetari nga Durrësi, kur nuk ka ndërtesa në Durrës,

mund të aplikojë për në Tiranë. Pra, lihet e hapur bazuar mbi këto specifika në mënyrë që të gjithë qytetarët të akomodohen.

Pra, dokumentet standarde janë formulari, i cili përmban të dhënat identifikuese dhe akti i konstatimit i hartuar nga Instituti i Ndërtimit. Pra, edhe në rast kur kemi të bëjmë me riparime, por ama për momentin objekti është i pabanueshëm, qytetarët përfitojnë. Pavarësisht këtij fakti, mund të jetë një sigurim 3-4 muaj deri në fazën që banesa bëhet e banueshme pasi bëhen riparimet përkatëse. Kështu që, ka një spektër për të pasur zgjidhje për të gjithë problematikat.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zoti Roshi, ju kërkoj ndjesë!

Artur Roshi – Ne nuk mund të jemi kundër mbështetjes së njerëzve që kërkojnë një orë e më shpejtë zgjidhjen e problemeve që u shkaktoi tragjedia e tërmetit. Mirëpo, duke mos pasur kohën e duhur në dispozicion për t'i parë më me qetësi dhe për të qenë më objektivë në këto që shprehim, në parim jemi pro.

Dua të tërheq vëmendjen për disa gjëra që vura re me një shikim të shpejtë. Ajo që duhet të ketë kujdes pushteti vendor është raporti që duhet të ruajë midis ndërtesave që do të prishin dhe atyre që do të ndërtojnë. Jo se nuk duhet parë në mënyrë rigoroze nëse vlen apo jo për të prishur, sepse këtë e vendosin ekspertët, problemi është të mos kalohet masa, sepse ka raste që mund të mos vlejë për të prishur, por të priset për shkak të interesave të tregut. Për shembull, vlera e truallit të një ndërtese gjashtëkatëshe kushton aq sa do të marrë pronari i tokës në qoftë se një ndërtues do ta zhvillojë në rrjedhën e lirë të tregut. Do të thotë që çdolloj ndërtuesi ka interes për të shembur një ndërtesë gjashtëkatëshe dhe për ta bërë dymbëdhjetëkatëshe. Këtu pushteti vendor duhet të jetë i vetëpërmbytur për të mos i nxitur ekspertët të nxjerrin ndërtime për t'u shembur kur atyre mund t'u bëhet rikonstruktion, sepse do të kërkojë një kohë të gjatë dhe do të mbetemi peng i kësaj kohëzgjatjeje për shkak të interesave të tregut.

Ne si opozitë në tërësi, opozita jashtë, brenda dhe të gjithë elementet e saj do ta monitorojmë dhe në qoftë se në të ardhmë do të ketë raste të tilla, ne do të marrim iniciativa ligjore dhe sigurisht do të jemi kritikë ndaj tyre. Kjo nuk do të thotë se ne duam të bëjmë politikë me çështjen e tërmetit ose me fatkeqësinë e njerëzve, por do të thotë të jemi rigorozë për të ardhmen e tyre, sepse e ardhmja e shqiptarëve është e përbashkët dhe ajo që na duhet është të shpenzojmë sa më pak për të ngritur një të ardhme më të mirë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Në referencë të asaj që thatë, zoti Roshi, keni të drejtë kur thoni që pushteti vendor duhet t'u kushtojë shumë vëmendje akteve të vlerësimit nëpërmjet specialistëve të certifikuar apo njësisë të certifikimit që mund të ketë vetë, në mënyrë që të prishen godinat që janë të pariparueshme apo banesat e pariparueshme dhe jo të lejohet abuzim.

Më duhet të them që bashkitë në zonat specifike që janë dëmtuar nga tërmeti së bashku me institucionet, por edhe me profesionet e lira, pra, inxhinierët dhe vlerësuesit që janë angazhuar në terren, janë shumë rigorozë me vlerësimet e tyre. Ndërkohë, ligji jep mundësinë e vlerësimit të thelluar aty ku ka dyshime nëse është goditur strukturalisht kjo ndërtesë pa kthim apo jo, por shqetësimi duhet përmendur.

Ka ndonjë koment tjetër në lidhje me ...?

Po, zoti Vullnet.

Vullnet Sinaj – Kam një pyetje për tërmetet e mëparshme.

Meqenëse nuk patëm kohë ta shikonim më hollësisht ligjin, a parashikohet që edhe ato shtëpi që janë dëmtuar (kam parasysh tërmetet në zonën që mbuloj) nga tërmeti i vitit 2018 dhe tërmeti i vitit 2019, një në zonën e Smokthinës dhe një në zonën e Kuçit) të përfitojnë nga ky ligj, në mënyrë që bashkë me këtë tërmet të mbyllën edhe ato pasoja? Kur folëm për fondin e emergjencave civile unë thashë që është e nevojshme ta mbyllim edhe këtë plagë të periudhës së kaluar për banorët e atyre zonave, të cilëve ju janë dëmtuar shtëpitë.

Arben Ahmetaj – Ju kuptova qartë. Ligj është pak a shumë si ligj organik, pra, është instrument në duart e qeverisë, të institucioneve që angazhohen apo edhe donatorëve, nëse doni ju, që të merret me pasojat e të gjitha fatkeqësive që kanë ndodhur apo të tërmetit të datës 26. Qeveria mund të ndërmarrë veprime në bazë të instrumenteve apo të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe pastaj kalimit në rindërtim në ato zona që preken jo vetëm nga tërmetet, por edhe nga fatkeqësi të tjera natyrore. Ajo që dëgjojmë brenda familjeve apo kudo që kemi shkelur në terren është “Do Zoti me kaq”.

Po, zoti Roshi.

Artur Roshi – Mund ta plotësoj unë përgjigjen, meqenëse jam i fushës, kryetar?

Pra, ne themi që krijohet një memorie e banesave nga tërmetet. Nëse tërmetet bien në kohë të ndryshme, memories së të parit i shtohet memoria e të dytit e kështu me radhë. Do të thotë që në tërmetin e fundit ndërtesa ka brenda edhe efektet e tërmeteve të mëparshme. Pra, do të thotë që ato duhet të përfshihen në këtë ligj, brenda logjikës së memories së çdolloj objekti. Kështu që, unë mendoj se defektet e tyre janë shtuar me këtë tërmet dhe besoj se janë brenda nga ana teknike.

Arben Ahmetaj – Ka ndonjë koment apo pyetje tjetër? Jo.

Para se të vazhdojmë me procesin e votimit, dua të falenderoj opozitën për mbështetjen që i jep ligjit “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”! Faleminderit për qëndrimet politike dhe njerëzore që mbani dhe bashkoheni me maxhorancën në këtë përpjekje për të përballuar pasojat dhe për t’i fshirë ato nga kujtesa sa më shpejtë!

Votojmë në tërësi aktin normativ “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet dhe kalon për votim në seancën e ditës së nesërme.

Vazhdojmë me votimin në tërësi të aktit normativ “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore të tërmetit të datës 26. 11. 2019”. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit opozitës dhe maxhorancës për mbështetjen që u jepni qytetarëve dhe qeverisë që të përballojnë pasojat!

Mbledhjen e komisionit e deklaroj të mbyllur.

Kalofshi mirë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti